



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja Ministry of Economic Development			
Njësia Org. Org. Jedin. Org Unit	02	Nr. Prof. Br. Prof Prof. No:	1298
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	2	Data Datum Date:	18.06.2013
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), nenin 38 (5) të Rregullores nr. 09/2011 për Punë të Qeverisë së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 15 / 12 shtator 2011), dhe nenin 17 (5 dhe 6) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare , nr.1 / 18 prill 2011) nxjerrë:

V E N D I M

1. Z. Sabit Gashi, Udhëheqës i Divizionit të balancave të Energjisë, caktohet Zyrtar Përgjegjës për hartimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-201 për Energjinë Elektrike (në tekstin e mëtejme: Zyrtari Përgjegjës).
2. Gjatë hartimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-201 për Energjinë Elektrike, Zyrtari Përgjegjës duhet t'i përmbahet rregullave dhe procedurave të parashikuara në Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe standardeve në fuqi për hartimin e legjislacionit.
3. Përveç hartimit të Projektligjit, Zyrtari Përgjegjës është i obliguar të administrojë tërë procesin e konsultimeve paraprake dhe publike sipas nenit 7 dhe 32 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011.
4. Zyrtari Përgjegjës në bashkëpunim me zyrtarët tjerë përkatës të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Zyrën Ligjore-ZKM dhe ministritë përkatëse, për gatitë dokumentet dhe kushtet e kërkuara me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
5. Pas përfundimit të hartimit të Projektligjit dhe dokumentacionit tjetër shoqërues sipas paragrafit 3 dhe 4 të këtij Vendimi, Zyrtari Përgjegjës Projektligjin ia dorëzon Udhëheqësit të Departamentit Ligjor i cili nëse nuk ka vërejtje, draftin e procedon te Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

6. Obligohen të gjitha njësitë përkatëse dhe zyrtaret e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për bashkëpunim dhe ofrimin e të dhënave të kërkuara nga Zyrtari Përgjegjës.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Z. Sabit Gashi
- Udhëheqësit të Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MZHE-së.

Prishtinë, 17.06.2013

